



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 19 Dt. 13 . 02 . 2017

“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI
ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “ GERTI sh.p.k.”

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pikës 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim të subjektit “ **GERTI sh.p.k.**”, me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore,Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “ **GERTI sh.p.k.**” me administrator **Z.Jeton DANI**, për përdorim të burimit ujor **përroi i Tuçepit** , për prodhim energjie elektrike, në fshatin Miresh, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti **HEC JETON** do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes: X- 44 58 972.4; Y - 45 91 367.5; Z - + 580 m

Koordinatat e godinës së centrali: X-44 57 855.1; Y - 45 95 210.5; Z - + 493 m;

Koordinatat e pikës së shkarkimit : X-44 57 855.1; Y -45 95 210.5; Z - + 493 m;

Prurja mesatare e burimit ujor: Qmes= 1.12 m³/sek;

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q llog= 1.75 m³/sek;

Prurja ekologjike Qekol= 0.197 m³/sek;

Prurja që shkarkohet: Q= 1.75 m³/sek.

2- Autorizimi i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3-Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Sekretari
Martin PLLUMBI

Kryetar
Paulin RADOVANI